

Shtojca 4 Aktivitetet dhe outputet (produktet) kryesore, Janar – Qershor 2017

	Aktiviteti	Outputi
Rezultati 1		
Outputi 1 Janë zhvilluar kurset e trajnimit për ofruesit e shërbimeve për përkrahjen e zbatimit të pakos së shërbimeve; të integruara në sistemin kombëtar të trajnimeve	Realizimi i tetë cikleve të trajnimit mbi Komunikimin dhe Këshillimin, në përputhje me planin e trajnimit	Është zhvilluar pakoja e trajnimit nga konsulentët kombëtarë në bazë të materialeve ekzistuese të trajnimit. Akreditimi – 6 pikë kredi. Janë realizuar 2 sesione trajnime nga konsulentët kombëtarë në qershor të vitit 2017 për grupet e Prishtinës dhe Gjakovës. 15 persona kanë ndjekur trajnimin në Prishtinë (2 m/ 13 f) dhe 19 në Gjakovë (5 m/14f).
	Realizimi i tetë cikleve të trajnimit mbi gjininë, në përputhje me planin e trajnimit	Është zhvilluar moduli për trajnimin 2 ditor të trajnerëve (TiT) dhe trajnimi është mbajtur nga Dr. Leah Bohle nga Swiss TPH në shkurt të vitit 2017, i ndjekur nga 21 pjesëmarrës (10 m/11 f). Akreditimi për TeT – 9 pikë kredi. Janë realizuar 2 trajnime me stafin e nivelit të institucionit nga trajnerët kombëtarë në maj të vitit 2017 për grupin e Prishtinës (3 m/15 f) dhe në qershor të vitit 2017 për grupin e Mitrovicës (3 m/16 f). Akreditimi – 6 pikë kredi.
	Zhvillimi/përditësimi i materialeve të trajnimit për një trajnim përkujtues të njohurive mbi kontrollin e infeksioneve. Akreditimi i EVM, nëse kërkohet	Është zhvilluar moduli 1 ditor për trajnim nga konsulentët kombëtarë në bazë të materialeve ekzistuese të trajnimit. Akreditimi në pritje.
	Zhvillimi dhe publikimi i materialeve edukative për kontrollin e infeksioneve	Akterët nuk kanë identifikuar nevojën për ndonjë material deri më tani.
	Realizimi i trajnimit përkujtues të njohurive mbi kontrollin e infeksioneve	Është realizuar rrethi i parë i trajnimit nga një trajner kombëtar për grupin e Prishtinës për 20 pjesëmarrës (5 m /15 f) në qershor të vitit 2017. Rrethi i dytë do të realizohet në shtator dhe i treti në tetor.
	Ueb-faqja e zhvilluar për ofrimin e një repozitori të përkohshëm për institucionet shëndetësore dhe/ose ofrimin e qasjes në resurset kombëtare/ndërkombëtare	Ueb-faqja e projektit AQH e zhvilluar dhe lansuar në mars të vitit 2017.

Outputi 2 Përkrahja e kapaciteteve të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për monitorim dhe vlerësim (M&V) të përmirësuar në komunat e përzgjedhura	Zhvillimi i pakos së trajnimit për M&V dhe planit të trajnimit	Pasi që M&V është i integruar brenda çdo moduli të trajnimit të menaxhmentit, gjatë këtij viti nuk do të zhvillohet ndonjë pako specifike e trajnimit.
	Punëtorja/tryeza e rrumbullakët për miratimin e planit	Si më lart.
	Akreditimi i pakos së trajnimit nga EVM	Si më lart
	Realizimi i trajnimit për M&V për mbledhjen dhe analizën e të dhënave në komunat ku do të realizohet pakoja e shërbimeve	Janë identifikuar 12 persona kontaktues/përgjegjës për M&V në fillim të vitit dhe është realizuar trajnimi në prill të vitit 2017.
	Pajisja e personave përgjegjës për M&V me pajisje të TI-së për mbledhjen e të dhënave	Laptopët dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave janë shpërndarë në trajnim.
	Fillimi i trajnimit për M&V në 8 komunat e mbetura.	Si më lart
	Krijimi i mekanizmave me IKSHP për menaxhimin e të dhënave për KPSH të gjeneruara nga komunat partnere të projektit.	Përfshirja e përfaqësuesve të IKSHP në Grupin Punues për Pakon e Shërbimeve për ofrimin e ekspertizës në lidhje me harmonizimin e të dhënave të Pakos së Shërbimeve (PSH)
	Dizajnimi i grupeve të të dhënave dhe mjeteve për M&V	Si më lart
	Inicimi i mbledhjes së të dhënave.	E filluar në maj të vitit 2017 për periudhën raportuese janar – qershor 2017.
	Mbështetja e mbledhjes së të dhënave nëpërmjet udhëzimit dhe monitorimit	Mbikëqyrja dhe udhëzimi nga Njësia për Implementimin e Projektit (NJIP)
	Mbështetja e analizës së të dhënave për planifikim vjetor	Lidhur me outputin 12.
Outputi 3 Është zhvilluar “Pakaja e shërbimeve” për sëmundjet “gjurmuese” (<i>tracer diseases</i>) dhe është garantuar qasja në këtë pako në institucionet pilote të KPSH	Mbështetja e KKUPK për hartimin dhe publikimin e udhërrëfyesve klinikë për Diabetin, Hipertensionin dhe Astmën	Është ofruar mbështetje logjistike për punëtoritë dhe mbledhjet e KKUPK-së, si dhe për 3 GP që zhvilluan udhërrëfyesit për diabet, hipertension dhe astmë. Udhëheqësit e Rezultatit 1 dhe 2 kanë marrë pjesë në të gjitha mbledhjet. KKUPK ka publikuar draft udhërrëfyesit në ueb-faqen e MSH në fund të muajit qershor të vitit 2017 për ofrimin e komenteve deri më 4 shtator.
	Përcaktimi i procesit për zhvillimin dhe aprovimin e pakos së shërbimeve	Dakorduar me grupin e ekspertëve të përbërë nga institucionet kombëtare, ekspertët e KPSH dhe komunat në të cilat realizohet Pakoja e Shërbimeve (PSH) në punëtorinë më 17 maj 2017. Është hartuar dokumenti raportues që përshkruan qasjen e projektit.
	Punëtorja mbi modalitetin dhe pakot kornizë të shërbimeve	Si më lart. Është dakorduar modeli i pakos së shërbimeve dhe draft plani i zbatimit për zhvillimin e PSH-ve gjatë eventit

		të njëjtë. Pas punëtorisë janë hartuar TeR-të dhe është themeluar GP për PSH në qershor të vitit 2017.
	Zhvillimi i pakos së shërbimit për Hipertension dhe Diabet	Janë përkthyer materialet e protokollit të WHO PEN. 4 nën-GP kanë krijuar: I. Modulin bazik ë trajnimit për edukatorët shëndetësorë (5 ditë) II. Modulin e trajnimit për Mjekët Familjarë mbi edukimin dhe promovimin shëndetësor për diabet dhe hipertension (2 ditë) III. Pasaportat dhe Regjistrat për Diabet dhe Hipertension IV. Materialet e Edukimit Shëndetësor/Promovimit Shëndetësor (19 tema) Drafti i parë i materialeve duhet të dërgohet në fillim të muajit shtator, pas periudhës së pushimeve.
	Aprovimi i pakos së shërbimeve	Grupi i ekspertëve ka arritur në përfundim se nuk kërkohet ndonjë miratim formal.
	Realizimi i trajnimit mbi pakon e shërbimeve në 4 komunat e përzgjedhura:	Janë realizuar 10 trajnime me stafin e nivelit komunal/të institucionit nga trajneri kombëtar me gjithsej 189 pjesëmarrës (64 m/ 125 f)
	Realizimi i punëtorive/trajnimit mbi përkthimin e udhërrëfyesve në protokolle institucionale	Ky aktivitet nuk do të ndërmerret nga projekti AQH gjatë vitit 2017. KKUPK do të zhvillojë protokolle për diabet, hipertension dhe astmë pasi të jenë miratuar udhërrëfyesit. Kjo do të pasohet nga trajnimi për lansimin kombëtar të udhërrëfyesve dhe protokolleve mbështetëse, me gjasë në vitin 2018.
	Identifikimi se cilat protokolle institucionale janë të nevojshme për zbatimin e pakos së shërbimeve	Konsulenca kombëtare në qershor të vitit 2017 për realizimin e vlerësimit të shpejtë të kapaciteteve të 39 objekteve për pako të shërbimeve për parandalimin e sëmundjeve jo ngjitëse duke përdorur pyetësin e WHO PEN, të modifikuar për kontekstin e Kosovës.
	Zhvillimi i protokolleve institucionale për pakon e shërbimeve	Raporti i konsulencës do të finalizohet në korrik të vitit 2017, pas së cilës kohë do të zhvillohen planet komunale për implementim në bazë të të gjetjeve të vlerësimit.
	Mbështetja e zbatimit të protokollit nëpërmjet udhë zimit dhe monitorimit	Aktiviteti i caktuar për korrik – dhjetor 2017.
	Mbështetja e IKSHP për realizimin e anketës STEPS 2017 (datat duhet të përcaktohen nga IKSHP)	Akoma nuk është përcaktuar data e fillimit për pyetësin – sipas shkallës aktuale të progresit, mund të mos fillojë gjatë vitit 2017.

	Konferenca kombetare për prezantimin e gjetjeve të pyetësorit STEPS (datat duhet të përcaktohen nga IKSHP)	Anketa nuk do të përfundohet gjatë vitit 2017; prandaj ky aktivitet do të shtyhet për vitin 2018.
Output 4 Është bërë zhvillimi, pilotimi dhe M&V i shërbimeve të kujdesit të integruar në nivel të komunitetit, me përkrahje nga komunitetet	Konferenca për Kujdesin e integruar	Konferenca një ditore në shkurt të vitit 2017, me pjesëmarrjen e 120+ përfaqësuesve të partnerëve zhvillimor, akterëve kombëtar dhe lokal, OJQ-ve ndërkombëtare dhe vendore që janë aktive në sektorin e shëndetësisë, agjencitë e OKB-së, grupi i KPSH/GTE dhe të krye trajnerëve në Mjekësinë Familjare. Përfaqësuesit nga projektet e shëndetësisë të financuara nga SDC në Shqipëri dhe Moldavi kanë marrë pjesë gjithashtu. Një punëtori e panelit të ekspertëve për akterët kyç të sektorit të shëndetësisë u zhvillua në ditën pasuese për të shqyrtuar temën në kontekstin e Kosovës.
	Themelimi i GP ndër-sektorial të nivelit kombëtar	Tryeza e rumbullakët me akterët e nivelit kombëtar për të shqyrtuar çështjet që ndërlidhen me temën, për t'u dakorduar për draft planin e zbatimit për zhvillimin e modelit të kujdesit të integruar dhe miratimin e përzgjedhjes së Fushë Kosovës si pilot komunë.
	Dakordimi mbi procesin me homologët për zhvillimin e një modeli të kujdesit të integruar për Kosovën	Draft plani i zbatimit i zhvilluar dhe miratuar gjatë ngjarjes së mësipërme.
	Dakordimi mbi kriteret për pilot komunën	Kriteret e dakorduara me SDC dhe përzgjedhja e Fushë Kosovës e miratuar nga përfaqësuesit e akterëve kombëtarë në ngjarjen e mësipërme.
	Përzgjedhja e pilot komunës	Si më lart
	Themelimi i grupit punues ndër-sektorial në nivel të pilot komunës	TeR-të janë zhvilluar dhe anëtarësimi është dakorduar.
	Dizajnimi i modelit të kujdesit të integruar, duke përfshirë politikat, udhëzimet, protokolet, procedurat standarde të operimit të nevojshme, etj.	Konsulenti ndërkombëtar është emëruar për mbështetjen e GP ndërsektorial në dizajnimin e modelit. Mbledhja e parë do të jetë një punëtori dy ditore, me 13/14 shtator 2017, pas periudhës së pushimeve.
	Përgatitja për pilotim.	Aktiviteti i caktuar për nëntor/dhjetor të vitit 2017.
	Pjesëmarrja në konferencën për kujdesin e integruar - Dublin	3 pjesëmarrës janë mbështetur për të marrë pjesë edhe pse 1 ka hequr dorë një ditë para udhëtimit për shkak të rrethanave personale.
Output 5 Pilot institucionet e KPSH-së kanë infrastrukturën dhe pajisjet e	Prokurimi i pajisjeve themelore për institucionet e KPSH sipas planit të zbatimit	Janë emëruar konsulentët ndërkombëtarë për udhëheqjen e procesit ndërkombëtar të tenderimit. Është hartuar plani i prokurimit. Janë dakorduar specifikimet e pajisjeve me grupin

nevojshme për ofrimin e pakos së shërbimeve		kombëtar të ekspertëve. Komiteti për Vlerësimin e tenderëve do të mbledhet në korrik të vitit 2017.
	Zhvillimi i MM-të/marrëveshjes së dorëzimit të pajisjeve dhe infrastrukturës në komunat partnere të projektit	Marrëveshja e dorëzimit për pajisjet themelore është përfshirë në planin e prokurimit. Është caktuar për periudhën e ardhshme raportuese
	Vlerësimi dhe prioritizimi i nevojave infrastrukturore	Modeli i PSH përfshin themelimin e Qendrave Burimore Shëndetësore (QBSH-të); megjithatë, është rënë dakord që këto të themelohen në të gjitha 12 komunat. Është zhvilluar specifikacioni për pajisjet.
	Zbatimi i investimeve infrastrukturore në institucionet e KPSH në 4 komunat e përzgjedhura, në harmoni me planin e dakorduar	Vlerësimet e infrastrukturës kanë filluar në muajin gusht të vitit 2017 dhe prokurimi është caktuar të fillojë në shtator të vitit 2017.
Output 6 Proceset dhe procedurat institucionale janë caktuar, (ri)dizajnuar dhe kthyer në praktikë	Mbështetja e MSH në zhvillimin e UA për Organizimin e Qendrave të Mjekësisë Familjare (SSSH Obj 3, 4.5.1)	Është ofruar mbështetje logjistike për GP të MSH gjatë kësaj periudhe raportuese. UA është finalizuar gjatë takimit 2 ditor në fund të muajit qershor 2017, mbështetur nga projekti me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm.
	Identifikimi i proceseve/rregulloreve institucionale që duhet të rishikohen/zvillohen në bazë të UA dhe dakordimi për procesin	Aktiviteti gjatë periudhës korrik – dhjetor 2017 pas miratimit të UA.
	Shqyrtimi i marrëveshjeve ekzistuese për menaxhimin e të kartelave mjekësore në nivel institucional	Auditimi i kartelave mjekësore në të gjitha 12 komunat ka filluar në qershor të vitit 2017 dhe do të përfundojë në shtator të vitit 2017 (e ndërlidhur me outputin 9).
	Mbështetja e komunave për të siguruar që të gjitha institucionet kanë sistem funksional të kartelave mjekësore (e ndërlidhur me outputet 2,3,4 & 5)	Në pritje të shqyrtimit të gjetjeve të auditimit.
	Shqyrtimi i protokolleve ekzistuese për referimin dhe referimin kthyes	Janë shqyrtuar 39 institucione të PSH në qershor të vitit 2017 si komponent i Vlerësimin të Shpejtë (e ndërlidhur me outputin 3).
	Puna me agjencitë përkatëse për rishikimin e protokoleve aktuale për referimin dhe referimin kthyes në komunat e pakos së shërbimeve	E përfshirë në modelin e PSH. Do të dakordohet me GP të PSH në aktivitetin e periudhës korrik - dhjetor 2017.
	Integrimi i protokolleve referuese në planin e zbatimit për institucionet ku do të realizohet pakoja e shërbimeve/spitali rajonal	Si më lart
	Mbështetja e zbatimit të protokollit referues nëpërmjet udhëzimit dhe monitorimit	Si më lart

	Mbështetja e QZHMF për auditimin e mekanizmave referues në komunat e pakos së shërbimeve	Sipas planit të dakorduar për zbatimin e PSH, kjo nuk do të ndërmerret këtë vit dhe ka gjasa të jetë një aktivitet për vitin 2018.
	Shqyrtimi i marrëveshjeve ekzistuese për menaxhimin e ankesave të pacientëve në nivel të institucionit/komunës	Është emëruar konsulenti ndërkombëtar dhe kombëtar. Shqyrtimi do të bëhet në shtator të vitit 2017.
	Zhvillimi i udhëzimeve dhe protokoleve për menaxhimin e ankesave në nivel të institucionit/komunës (e ndërlidhur me aktivitetet e outputit15)	Në pritje të gjetjeve të shqyrtimit. Ka gjasa të shtyhet për vitin 2018 kur kihen parasysh ngarkesat/kërkesat mbi drejtuesit komunal.
	Mbështetja e zbatimit të protokoleve për menaxhimin e ankesave nëpërmjet trajnimit dhe monitorimit (e ndërlidhur me aktivitetet e outputit15)	Si më lart
Outputi 7 Janë zbatuar sisteme të mbikëqyrjes mbështetëse (përfshirë trajnimin (<i>coaching</i>) përgjatë vijave të referimit	Realizimi i punëtorisë dy ditore, mbi parimet e mbikëqyrjes mbështetëse	Trajnimi 2 ditor fillestar në mars të vitit 2017, me punëtori pasuese në prill të vitit 2017 për zhvillimin e modelit dhe mjeteve. Punëtorja e mëtejshme me GTE të KPSH në prill për të finalizuar mjetet e mbikëqyrjes.
	Krijimi i procesit për zhvillimin e modelit të mbikëqyrjes mbështetëse.	Është emëruar konsulenti ndërkombëtar për të ofruar trajnim dhe mentorim për zbatimin e mjeteve në 5 komuna, duke filluar nga korriku i vitit 2017.
Rezultati 2		
Outputi 8 Është zhvilluar dhe aplikuar një pako e trajnimit të menaxhmentit për institucionet e KPSH-së	Pakoja e trajnimit për menaxhment e akredituar nga bordi i ZHVP i MSH	Pakoja e trajnimit është akredituar nga bordi i ZHVP me gjithsej 72 pikë kredi.
	Vendimi i Komitetit Drejtues të projektit AQH për përgjegjësinë institucionale për qëndrueshmërinë e trajnimit të menaxhmentit	Pas konsultimeve të gjera me të gjithë akterët relevantë, është sugjeruar që QZHMF duhet të jetë institucioni kombëtar përgjegjës për qëndrueshmërinë e trajnimit të menaxhmentit. Kjo është aprovuar nga Komiteti Drejtues i projektit, i kryesuar nga Ministri në prill të vitit 2017.
	Programi 'themelorr' i trajnimit të menaxhmentit është mbajtur për menaxherët e lartë të 12 komunave partnere të projektit dhe Trajnimi i Trajnerëve (TiT).	25 menaxherë të lartë nga 12 komunat partnere të projektit dhe 10 TiT (7 nga QZHMF dhe 3 nga QEVI) kanë përfunduar me sukses raundin e parë të trajnimit të përfunduar në maj të vitit 2017. Ky raund përbëhej nga 6 module kryesore dhe një modul shtesë "Si të planifikojmë me sukses".
	Vlerësimi i ciklit të parë dhe përgatitja për ciklin e dytë të trajnimit të menaxhmentit	Punëtorja për vlerësim është mbajtur më 14 qershor 2017. Në përgjithësi, trajnimi i menaxhmentit ka marrë vlerësim të

		lartë pozitiv. Rekomandohen ndryshime të vogla në aspektin e kohëzgjatjes të disa moduleve gjatë ciklit të ardhshëm të trajnimit. Mbledhja e parë përgatitore me TeT është mbajtur më 27 qershor 2017.
Outputi 9 Stafi komunal i trajnuar dhe përkrahur për të realizuar auditimin e cilësisë për pëmirësimin e M&V në institucionet shëndetësore	Realizimi i trajnimit mbi auditimin e cilësisë dhe ISO standardet për Koordinatorët e Cilësisë të 12 komunave partnere të projektit	Trajnim 3 ditor mbi auditimin e cilësisë, përfshirë ISO standardet, është zbatuar në periudhën 22-24 mars 2017. Trajnimi është akredituar nga MSH me 8 pikë kredi dhe është ndjekur nga 12 Koordinatorë të Cilësisë, 10 Inspektorë Shëndetësorë dhe Shefi i Divizionit për Sigurim të Cilësisë në MSH.
	Mbështetja e Koordinatorëve të Cilësisë për zhvillimin e planit vjetor për auditimet e cilësisë (shqyrtimi i opsioneve për akreditim me MSH)	Në konsultim me koordinatorët e cilësisë, është vendosur që të mbështetet çdo komunë partnere e projektit për të realizuar një auditim klinik këtë vit, me fokus në përdorimin e kartelave mjekësore. AQH ka punësuar dy ekspertë vendorë për të monitoruar koordinatorët e cilësisë përgjatë këtij procesi si mekanizëm për shkëmbimin e praktikave më të mira nëpër komuna, përfshirë komunat që nuk janë partnere të AQH-së.
	Mbështetja e zbatimit të auditimeve të cilësisë (1 auditim i cilësisë për komunë)	Auditimet kanë filluar në qershor dhe do të përfundojnë në shtator të vitit 2017.
	Punëtorja me 12 komuna për të shqyrtuar procesin dhe për të shkëmbyer mësimet e nxjerra	Punëtorja është planifikuar për fundin e muajit shtator, pas përfundimit të auditimeve klinike
Outputi 10 Projekte të vazhdueshme të përmirësimit të cilësisë që i përgjigjen nevojave të pacientëve zbatohen në nivel institucional	Vazhdimi me zbatimin e Projekteve për Përmirësimin e Cilësisë (PPC-ve) të financuara në vitin 2016	Për shkak të procedurave të prokurimit dhe rehabilitimit, raundi i parë nuk ka përfunduar deri në fund të kësaj periudhe raportuese.
	Vlerësimi i vitit të parë të procesit të PPC-së dhe rishikimi i procesit në bazë të të gjeturave dhe rekomandimeve	Vlerësimi është bërë nëpërmjet një punëtorie pjesëmarrëse të mbajtur më 14 qershor 2017.
	Lansimi i trajnimit për PPC në nivel të grupit	Koordinatorët e Cilësisë të trajnuar mbi Menaxhimin e Cilësisë, duke përfshirë ISO standardet në mars të vitit 2017 (e ndërlidhur me outputin 9).
	Lansimi i thirrjes për ciklin e dytë të PPC-ve	Thirrja për raundin e dytë të PPC-ve është lansuar formalisht gjatë punëtorisë në qershor dhe komunat priten të dërgojnë draftin e parë të PPC-ve deri në fillim të muajit shtator të vitit 2017.
Outputi 11 Janë zhvilluar dhe pilotuar procedurat për shqyrtim profesional dhe për krahasim me një pikëreferim (benchmarking)	Realizimi i trajnimit mbi proceset për shqyrtim profesional dhe krahasimit me pikëreferim (<i>benchmarking</i>) për Koordinatorët e Cilësisë	Koordinatorët e Cilësisë dhe Drejtorët e QKMF kanë ndjekur trajnimin njoftues mbi parimet e shqyrtimit profesional dhe krahasimit me pikëreferim, në shkurt të vitit 2017.
	Mbështetja e Koordinatorëve të Cilësisë për të zhvilluar dhe zbatuar planin vjetor për shqyrtim profesional dhe krahasim me një pikëreferim	Duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara të Koordinatorëve të Cilësisë, ata do të mbështeten për të fituar përvojë në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të

		shqyrtimit profesional nëpërmjet pjesëmarrjes në shqyrtimin e përbashkët profesional me kolegët nga Shqipëria. E caktuar për shtator/tetor 2017.
	Mbështetja e pjesëmarrjes në konferencën evropiane WONCA për KPSH	Është mbështetur pjesëmarrja e drejtorëve të QKMF nga Vushtrria dhe Fushë Kosova dhe asistenti i projektit AQH (2 femra/1 mashkull). Delegacioni i Kosovës ka bërë dy prezantime: 1) PPC-të dhe 2) Anketa për Cilësi të Kujdesit.
	Mbështetja e një aktiviteti të rjetëzimit rajonal të KPSH (data duhet të confirmohet)	Përfaqësuesit rajonalë janë ftuar për të marrë pjesë në konferencën për Kujdesin e Integruar në shkurt të vitit 2017. AQH ka konfirmuar mbështetjen për Konferencën e 5-të Ndërkombëtare të Mjekësisë Familjare të QZHMF, që do të realizohet nga 25-26 shtator 2017 dhe gjithashtu do të mbështesë Konferencën e ESH/PSH të IKSHP në tetor të vitit 2017.
Output 12 Komunitat pilot angazhohen në planifikimin vjetor të shëndetësisë dhe hartojnë Master Plane shëndetësore	Është realizuar trajnimi "Si të planifikojmë me sukses" dhe moduli "Planifikimi dhe zbatimi i shërbimeve të KPSH".	E ndërlidhur me outputin 8, menaxherët e lartë (12 drejtorë të QKMF dhe 13 drejtorë të DSHMS) morën pjesë në trajnimin shtatë ditor me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të menaxherëve shëndetësorë për planifikimin e shërbimeve të KPSH. Përveç kësaj, si pjesë e pakos së trajnimit për menaxhmentin, menaxherët e përmendur më lart ndoqën një modul katër ditor mbi planifikimin dhe zbatimin e shërbimeve të KPSH.
	Shqyrtimi i procesit aktual komunal të planifikimit vjetor në krahasim me trajnimin mbi planifikimin dhe mbështetja e zhvillimit të mjeteve për planifikimin e sektorit shëndetësor për planifikimin vjetor të shërbimeve KPSH	Drejtorët e DSHMS dhe QKMF kanë pasur mundësinë të shqyrtojnë procesin e tyre të planifikimit përderisa merrnin pjesë në sesionet e grupeve të vogla të trajnimeve të mësipërme. Përveç kësaj, ata janë pajisur me njohuri dhe aftësi për zhvillimin dhe përdorimin e mjeteve për planifikim vjetor.
	Mbështetja e komunave për zhvillimin e planifikimit pjesëmarrës vjetor të shërbimeve të KPSH-së për vitin 2018	Aktivitet i planifikuar për periudhën korrik - dhjetor 2017. Është arritur dakordimi me komunitetet që AQH-ja do të mbështesë komunitetin e Gjakovës dhe Mitrovicës për pilotimin e përfshirjes së komunitetit në procesin e planifikimit vjetor.
	Punëtorja për përcaktimin e modelit të master planit të shëndetësisë	Punëtorja u mbajt më 14 qershor 2017. Është kërkuar mbështetje teknike, prandaj caktimi i konsulentit ndërkombëtar për mbështetjen e këtij aktiviteti është në proces e sipër.
	Dakordimi i procesit për zhvillimin e master planit.	Aktivitet i planifikuar për periudhën korrik - dhjetor 2017.

Rezultati 3		
Outputi 13 IKSHP mbështetet për zhvillimin dhe zbatimin e një pakoje të trajnimit mbi aftësitë e komunikimit për promovimin dhe edukimin shëndetësor për udhëheqësit e komunitetit/OSHC-të/OBK-të	Mbështetja e IKSHP-së për zhvillimin e standardeve mbi materialet e ESH/PSH	Është angazhuar konsulenti ndërkombëtar. Punëtorja e parë u mbajt në mars 2017 dhe ofroi një hyrje në praktikat më të mira për materialet ESH/PSH. Është ofruar mbështetje e vazhdueshme për t'i ndihmuar IKSHP-së me zhvillimin e standardeve/procedurave për prodhimin dhe miratimin e materialeve të ESH/PSH të prodhuara nga organizatat e tjera. Standardet u finalizuan në qershor, megjithatë IKSHP-ja nuk dëshiroi t'i lansojë ato deri në konferencën mbi ESH/PSH në tetor 2017 (shih më poshtë).
	Mbështetja e IKSHP-së për finalizimin e Strategjisë Kombëtare për ESH/PSH	Strategjia nuk është publikuar ende, prandaj AQH-ja është pajtuar të mbështesë konferencën e IKSHP-së në tetor 2017 në mënyrë që strategjia të mund të lansohet zyrtarisht.
	Pjesëmarrja në Konferencën e 5-të Ndërkombëtare të Shëndetit Publik, Shqipëri 2017	14 pjesëmarrës nga institucionet (e ESH/PSH) të nivelit kombëtar, rajonal dhe komunal morën pjesë, si dhe 2 punonjës të NjIP-it. Delegacioni bëri 3 prezantime: 'Sondazhi KAPB për Kosovën 2016'; 'Pirja e duhanit të mësimdhënësit e shkollave fillore në Maqedoni'; dhe 'Sëmundjet malinje të gjirit dhe traktit gjenital femëror të raportuara në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, 2012-2014'.
	Furnizimi i tri ISHP-ve rajonale me pajisjet themelore për realizimin e aktiviteteve të ESH/PSH	Me kërkesë të IPH-ve rajonale, janë furnizuar disa pajisje themelore, si laptopë dhe projektorë, fletë rrotulluese (flip chart), etj., si dhe pajisje për matjen e shtypjes së gjakut dhe glukometra. Pajisjet u furnizuan gjatë majit 2017
	AQH-ja e mbështet IKSHP-në për të funksionalizuar komisionet e ESH/PSH në nivel komunal	Është planifikuar për korrik-dhjetor 2017 varësisht prej gjetjeve të vlerësimit.
	Mbështetja e IKSHP-së për krijimin dhe funksionalizimin e qendrës trajnuese për ESH/PSH në kuadër të IKSHP-së bazuar në projekt Strategjinë e ESH/PSH	Strategjia e IKSHP-së nuk është lansuar ende dhe deri më tash IKSHP-ja nuk ka kërkuar mbështetje për këtë aktivitet. Diskutime të mëtejme për të qartësuar mbështetjen/veprimet e nevojshme dhe afatet kohore për krijimin dhe funksionalizimin e qendrës së trajnimit do të zhvillohen në periudhën e ardhshme raportuese, megjithëse gjasat janë të mëdha që kjo të mos realizohet gjatë 2017-ës.
	Mbështetja e IKSHP-së për zhvillimin e pakove të trajnimit mbi aftësitë e komunikimit për ESH/PSH dhe mbajtja e trajnimeve për trajnuesit e ESH/PSH	TeR për mbështetjen e IKSHP-së për zhvillimin e pakove të trajnimit mbi aftësitë e komunikimit për ESH/PSH janë hartuar por duhet të rishikohen dhe përshtaten me strategjinë e NSS-së dhe pakon e trajnimit për edukatorët shëndetësorë sipas outputit 3.

	Mbështetja e IKSH-ve për prodhimin e planit të trajnimit për udhëheqësit e komunitetit/OSHC-të/OBK-të	Kjo do të planifikohet dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë me IKSH-ve.
	Mbështetja e IKSH-ve për ofrimin e trajnimit	Kjo do të planifikohet dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë me IKSH-ve.
	Zhvillimi i planit të punës për ESH/PSH për parandalim të sëmundjeve në bashkëpunim me IKSH-ve dhe komunat	Plani i punës i ESH/PSH për parandalim të sëmundjeve do të finalizohet pasi të publikohet Strategjia për ESH/PSH.
Outputi 14 Komunitetet dhe grupet e cenueshme janë mbuluar me aktivitetet e promovimit dhe të edukimit shëndetësor për problemet e zakonshme shëndetësore, praktikat e shëndetshme dhe mbi atë se kur/ku mund të kërkojnë kujdes.	Vlerësimi i proceseve/strukturave aktuale të ESH/PSH në nivel institucioni	Konsulenca kombëtare për vlerësimin e proceseve/strukturave aktuale të ESH/PSH në nivel institucioni. Raporti ofron të dhëna të hollësishme mbi të gjeturat/analizën dhe rekomandimet mbi relevancën e proceseve/strukturave ekzistuese, si dhe ofron bazën për diskutime dhe veprime të mëtejme që duhet të dakordohen me IKSH-ve e që duhet të çojnë në funksionalizimin e KESH-ve në nivel komunal.
	Hartimi dhe prodhimi i drafteve të materialeve të KNS/IEK në përputhje me planin	Është formuar GP për zhvillimin e përmbajtjes teknike për materialet e ESH/PSH për 19 tema që ndërlidhen me hipertensionin dhe diabetin. Dizajnimi i materialeve përfshihet në TeR për agjencinë krijuese.
	Para-testimi i materialeve KNS/IEK dhe përcaktimi i metodave/kanaleve më efektive të komunikimit	Është përfshirë në TeR për agjencinë krijuese. Është planifikuar për periudhën e raportimit korrik-dhjetor.
	Prodhimi i versioneve përfundimtare të materialeve KNS/IEK	Është përfshirë në TeR për agjencinë krijuese. Është planifikuar për periudhën e raportimit korrik-dhjetor.
	Zhvillimi i fushatave të ESH/PSH përmes OJQ-ve të zgjedhura të projektit (faktorët e rrezikut; diabeti; hipertensionin; të ushqyerit e shëndetshëm, etj.)	Aktivitetet e ESH/PSH për diabetin dhe hipertensionin janë përfshirë në marrëveshjet e shërbimit me OJQ-të për korrik-dhjetor.
	Mbështetja e OJQ-ve të projektit për realizimin e aktiviteteve trajnuese për komunitetet (faktorët e rrezikut; diabeti; hipertensionin; të ushqyerit e shëndetshëm, etj.)	1,503 anëtarë të komunitetit ndoqën seancat edukative mbi imunizimin nga 12 komuna (638 m/865 f). Pajisjet themelore për realizimin e aktiviteteve të ESH/PSH u janë ofruar 3 OJQ-ve duke përfshirë pajisjet për monitorimin e shtypjes së gjakut dhe glukometrat, të cilat do të nevojiten për trajnim lidhur me hipertensionin dhe diabetin.
	Monitorimi i OJQ-ve të projektit	Në përputhje me Marrëveshjen e Shërbimit, raportet e OJQ-ve mbi aktivitetet e realizuara dorëzohen para lëshimit të fondeve të mëtejme. Vizitat në terren nga kryesuesi i outputit 3 për të monitoruar cilësinë e trajnimeve të ofruara.

	Mbështetja e MSh-së lidhur me SSSH-në dhe/ose e IKSHP-së lidhur me aktivitetet e edukimit shëndetësor të Strategjisë për ESH/PSH sipas planit të punës	Prioritetet e SSSH-së dhe ESH/PSH janë pasqyruar në Strategjinë NSS të AQH-së. Strategjia Kombëtare e ESH/PSH është duke u rishikuar nga MSh-ja dhe pritet të finalizohet/miratohet në tetor 2017. Pasi të finalizohet strategjia, AQH-ja do të diskutojë, dakordohet dhe ofrojë mbështetje për IKSHP-në.
	M&V i aktiviteteve/fushatave të realizuara	M&V është përfshirë në TeR për agjencinë krijuese. 2 fushatat e para janë planifikuar për periudhën raportuese korrik – dhjetor 2017
	Zhvillimi i pakos së trajnimeve për komunitetet dhe grupet e cenueshme lidhur me faktorët e rrezikut për hipertension dhe diabet	Është formuar GP për zhvillimin e përmbajtjes teknike për materialet trajnuese të ESH/PSH mbi hipertensionin dhe diabetin për edukatorët shëndetësorë dhe stafin klinik. Këto materiale do të finalizohen dhe pastaj përshtaten për edukim të komunitetit në periudhën korrik-dhjetor.
	Zhvillimi i pakos së trajnimeve për komunitetet dhe grupet e cenueshme mbi të ushqyerit e shëndetshëm dhe aktivitetin fizik	Si më lart
	Zhvillimi i pakos së trajnimeve mbi sjelljet e shëndetshme për hipertensionin dhe diabetin (ndërlidhet me aktivitetet e outputit 3)	Si më lart
	Trajnimi TiT për edukatorët shëndetësorë në kuadër të Komisioneve të ESH (ndërlidhet me aktivitetet e outputit 13)	Përmbajtja e modulit të trajnimit 5-ditor është dakorduar dhe është formuar GP për zhvillimin e materialeve trajnuese. Raundi i parë i trajnimeve do të fillojë në tetor 2017.
	Trajnimi i Komisioneve të ESH dhe OJQ-ve të përzgjedhura lidhur me pakot (ndërlidhet me outputin13)	Është formuar GP për zhvillimin e përmbajtjes teknike për materialet trajnuese të ESH/PSH mbi hipertensionin dhe diabetin për edukatorët shëndetësorë dhe stafin klinik. Këto materiale do të finalizohen dhe pastaj përshtaten për edukim të komunitetit në periudhën korrik-dhjetor.
Outputi 15 Udhëheqësit e zgjedhur të komunitetit/OSHC/OBK kanë kapacitete të avokojnë për të drejtat e pacientëve dhe të angazhohen në mekanizmat e reagimit me menaxherët dhe ofruesit e shërbimeve shëndetësore.	Zhvillimi i planit vjetor për ngritjen e kapaciteteve me PRAK-un	Plani i zhvilluar
	Realizimi i aktiviteteve të dakorduara për ngritjen e kapaciteteve të PRAK-ut	Aktivitetet e planifikuara për nëntor/dhjetor 2017
	Zhvillimi i kapaciteteve të PRAK-ut për vendosjen e sistemeve dhe procedurave për të siguruar identifikimin dhe adresimin e nevojave të komunitetit	Kjo do të arrihet duke siguruar pjesëmarrjen e anëtarëve të komunitetit në qasje të përzgjedhura të llogaridhënies: Fletënotimi(kartela e pikëve) i Komunitetit (FNK) dhe Vlerësimet e Jashtme.
	Mbështetja e PRAK-ut për të zhvilluar kapacitetet e përfaqësuesve të komunitetit për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet planifikuese të sektorit shëndetësor	AQH do të synojë të eksplorojë ngritjen e kapaciteteve të një OQJ-je të përzgjedhur për dizajnimin, realizimin dhe monitorimin e vlerësimin e kartelës së pikëve për komunitetin dhe një qasje të vlerësimit të jashtëm me anëtarë të komunitetit në një deri dy komuna pilot. Projekti do të

		shfrytëzojë përvojën e “Save the Children” për të rritur cilësinë e arsimit duke përdorur FNK për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore.
	Mbështetja e PRAK-ut për të avokuar dhe lobuar për ndryshimin e Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor	Ky aktivitet do të fillojë nga shtatori 2017 pasi të mbahet trajnimi për ngritjen e kapaciteteve mbi të Drejtat e Pacientit për PRAK-un
	Zhvillimi i planit vjetor për ngritjen e kapaciteteve me Zyrën për të Drejtat e Pacientëve, MSh	Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve janë dakorduar me Zyrën për të Drejtat e Pacientëve.
	Ngritja e kapaciteteve të Zyrës për të Drejtat e Pacientëve lidhur me menaxhimin e ankesave	Vizita studimore lidhur me mekanizmat e ankesave në Ankara, Turqi. Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, projekti AQH ka mbështetur pjesëmarrjen e 8 pjesëmarrësve në një vizitë studimore mbi Mekanizmat e Ankesave nga 25 deri 28 prill 2017 në Ankara, Turqi. Në mesin e pjesëmarrësve ishin: Zëvendës ministri i MSh-së, një këshilltar i MSh-së, 2 përfaqësues nga Departamenti i Linjës Telefonike për ankesat e qytetarëve (MSh), 1 përfaqësues nga Divizioni për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor (MSh), 1 përfaqësues nga Inspektorati Shëndetësor (MSh), 1 përfaqësues nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK) dhe 2 përfaqësues nga projekti AQH.
	Mbështetja e PRAK-ut për rishikimin e procedurave ekzistuese dhe identifikimin e planit për përmirësimin e menaxhimit të ankesave të pacientëve	PRAK ka kapacitete të kufizuara teknike për udhëheqjen e këtij aktiviteti, prandaj janë angazhuar konsulentë ndërkombëtarë dhe vendorë për ta bërë këtë rishikim. Konsulenca do të bëhet gjatë shtatorit 2017.
	Zhvillimi dhe zbatimimi i udhëzimeve/procedurave për menaxhimin e ankesave të pacientëve në nivel të institucioneve shëndetësore/komunave (ndërlidhet me Autputin 6)	Do të përcaktohet sipas përfundimeve të rishikimit.
	Mbështetja e PRAK-ut për realizimin e planit të aktiviteteve lidhur me ankesat	Do të përcaktohet sipas përfundimeve të rishikimit.
	Mbështetja e PRAK-ut për publikimin dhe mirëmbajtjen e uebfaqes së tyre	Korrik-dhjetor 2017